



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.5.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për vreshtarinë dhe verën”. (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Fadil Nasufi, Laert Duraj, Luljeta Bozo, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Lefter Gështenja, Zef Hila, Xhelal Mziu, Agron Duka dhe Nusret Avdulla.

Mungojnë:

Tatiana Piro, Rrahman Rraja, Benet Beci, Flamur Hoxha, Fatjon Veizaj dhe Ramadan Likaj.

Të ftuar:

Alban Mesonjësi – Drejtor në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Julinda Bare – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Agim Rrapaj – Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar

Aulona Veizi – Eksperte e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar

Gazmend Shehi – Kryetar i Shoqatës së Prodhuesve të Verës

Roland Dama – Shoqata e Prodhuesve të Verës

Rigers Kaçorri – Shoqata e Prodhuesve të Verës

Ersol Caci – Shoqata e Prodhuesve të Verës

Evald Domi – Shoqata e Prodhuesve të Verës

Levent Nurellari – Shoqata e Prodhuesve të Verës

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Mirëdita!

Sot do të vazhdojmë me shqyrtimin e ligjit “Për vreshtarinë dhe verën”, të cilin e kemi filluar ditë më parë.

Në rendin e ditës kemi programuar një seancë dëgjimore.

Kemi mjaft të ftuar sot nga Këshilli i Agrobiznesit, nga Shoqata e Prodhuesve të Verës, gjithashtu, edhe nga Ministria e Bujqësisë.

Ne e kemi filluar diskutimin në parim, por të gjithë kolegët janë të interesuar të dëgjojnë sa më shumë për të kuptuar akoma më mirë, në mënyrë që të mund të prodhojmë një ligj që t’u shërbejë atyre që merren përditë me këtë punë, por edhe rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe eksportuese të vendit, duke qenë se tashmë jemi të gjithë koshientë se ky produkt ka njohur rritje eksponenciale në vend.

Kush dëshiron të fillojë?

Urdhëroni, zoti Rrapaj!

Agim Rrapaj – Faleminderit, kryetar!

Me këtë projektligj ne jemi njohur, kemi bërë një diskutim të gjatë me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural. Kemi bërë vërejtjet tona që në pjesën më të madhe janë marrë parasysh, por një pjesë e tyre nuk janë marrë parasysh. Për këtë ne kemi ardhur sot këtu që t’ju bëjmë me dije për specifikat që ka ky ligj.

Ky është një ndër projektligjet e diskutuara dhe të konsultuara me sektorin privat më gjerë se gjithë projektligjet e tjera dhe një kohë më të gjatë. Ne kemi qenë mjaft të interesuar dhe Akademia e Shkencave e ka organizuar për këtë çështje një simpozium të veçantë, ku ne kemi qenë pjesëtarë bashkë me Akademinë e Shkencave të Kosovës dhe them se miratimi i këtij projektligji do të jetë një shtysë shumë e madhe për sa i përket zhvillimit të këtij sektori dhe sfidave që e presin.

Unë do t’ia jepja fjalën Gazit që është kryetar i shoqatës për të folur konkretisht për disa nga detajet që mendojmë se duhet t’u bëhen me dije deputetëve.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Rrapaj!

Urdhëroni, zoti Shehi!

Gazmend Shehi – Përshëndetje!

Faktikisht ne, siç e tha edhe zoti Rrapaj, kemi qenë pjesë e tryezave dhe kemi bërë disa rekomandime nen për nen. Mendoj që duhet të përqendrohemi në disa pika kryesore. Nuk e di a duhet ta marr fjalën nen për nen apo duhet propozoj disa gjera tani.

Arben Pëllumbi – Ne sot këtu do të bëjmë një diskutim të përgjithshëm për t'u njohur, pastaj të gjitha propozimet, që ju keni për ndërhyrje në nene të caktuara, do të na i jepni me shkrim.

Ideja është që ne sot të kuptojmë nga ju se cilat janë ato pika që ju mendoni se duhen përmirësuar në këtë projektligj që është paraqitur sot.

Gazmend Shehi – Ne kemi parë disa modele, kryesisht në Europë që e kanë zgjidhur me një qendër kombëtare të kontrollit të origjinës së verës dhe kemi propozuar që Shqipëria të ketë një qendër kombëtare të mbrojtjes së origjinës. Kjo flet edhe për produktin vendas, por edhe për origjinën e verërave që vijnë nga importi. Kjo qendër duhet të kontrollojë cilësinë, të jetë kombëtare, me kompetencë ndoshta edhe Ministria e Bujqësisë, por edhe nga ndonjë institucion tjetër. Kështu e kanë edhe vendet e tjera që një grup specialistësh ndërsektorialë që mbrojnë origjinën e verës.

Ne kemi parë që akoma Shqipëria nuk e ka përmbushur kadastrimin e plotë të vreshtarisë. Ky është një nga ato elemente që nuk është përmbushur, prandaj është vonuar ligji. Ne mendojmë se duhet të përmbushet kadastrimi, duhet të ndahen zonat gjeografike, sipas rajoneve që kultivojnë vreshtari, pastaj ne mund të kalojmë në mbrojtjen e treguesve të origjinës. Mendoj se origjina është element shumë i rëndësishëm për ta mbrojtur verën shqiptare, por edhe për t'u bërë në të ardhmen marka tregtare që mund të eksportojmë.

Nuk e di pse nuk është bërë kadastrimi i plotë. Me sa dimë ne, ka pasur disa projekte edhe nga BE-ja për këtë çështje, por janë bërë vetëm dy qarqe, nuk është përmbushje e plotë.

Mendimi ynë është që të përmbushet komplet kadastrim, pastaj ne të kalojmë në mbrojtjen e treguesve gjeografikë, ose duhet të përcaktohen me ligj edhe këto rajonet që nuk janë të përcaktuara, pastaj le të kalojmë në mbrojtjen e treguesve gjeografikë dhe treguesve të origjinës.

Ne mendojmë se një pikë kritike është një nen për importet. Ky nen është marrë nga Rregullorja e BE-së dhe vetëm dy fjalë shkruhen. Ne nuk kemi bërë propozimet tona që nuk duhet të mjaftohemi që një subjekt me një licencë të importojë verë në Shqipëri, duhen disa kritere fikse për sektorin e importit të verës dhe ne mendojmë se një importues duhet ta regjistrojë këtë produkt që fut në Shqipëri, në këtë qendrën kombëtare, pastaj, pas kodifikimit, do të analizohet nga dy panelet, në panelin e analizave fiziko-kimike dhe në

panelin e shijimit të verërave, pastaj ta hedhë në treg produktin, sepse ne kemi parë, jemi koshentë që në këta 30 vjet është një rrëmuje e madhe për sa i përket sektorit të verës.

Ne jemi shumë jokonkurrues për shumë arsye, sepse ka import të lartë, sepse këto struktura ne nuk i kemi, kurse vendet e tjera i kanë (kontrollin e origjinës).

Mendoj se këto janë dy-tri pikat që me një vullnet ose në një kohë të caktuar, 2-3 vjet ndoshta, si punë amnistie për të gjithë aktorët, t'i rregullojnë këto gjëra, të bëhemi konkurrues dhe të promovojmë produktet tona.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Shehi!

Nga të gjitha bisedat që kemi bërë me kolegët, por edhe bashkëbisedimin me propozuesit e projektligjit, unë besoj se qëllimi nuk është thjesht të bëjmë një ligj për ta rregulluar këtë sektor, meqenëse duhet rregulluar. Ideja është që të bëjmë një ligj, i cili t'i rezistojë kohës dhe, në radhë të parë, t'ju vijë në ndihmë ju në aktivitetin e përditshëm që bëni këtu, por, mbi të gjitha, në rritjen e eksportit.

Ne kemi diskutuar, kur bënë seancën e diskutimeve në parim, për mënyrën se si importohet sot dhe për faktin që qindra e mijëra hektolitra të një vere, ndoshta jociësore, hyjnë sot në treg, duke bërë një konkurrencë të pandershme.

Unë nuk e di, nëse ky ligj arrin dot ta plotësojë këtë gjë, sepse ne jemi edhe pjesë e MSA-së dhe tregjeve të hapura, por të mund të bëjmë një ligj të tillë, i cili, në radhë të parë, t'ju mbrojtë ju këtu brenda vendit dhe, nëse ka nevojë pastaj që të bëhet edhe regjistrimi i produkteve, edhe ai do të bëhet, por në përgjithësi do të shikojmë se çfarë mund t'i përmirësojmë këtij materiali që na ka ardhur për të qenë ju, prodhuesit shqiptarë, të parët, të cilët të ndiheni mirë prej tij. Ky është qëllimi i të gjithë diskutimit që kanë bërë kolegët, pavarësisht krahëve.

Nga ajo që unë dëgjova sot, por u diskutua edhe herën tjetër, është kadastrimi i plotë.

Çfarë nënkupton kadastrimi i plotë? A mund të na e shtjelloni pak më shumë?

Gazmend Shehi – Ne kemi parë që në sektorë të tjerë quhet matrikullim, do të thotë që çdo bimë hardhie të jetë në një program të caktuar dhe çdo varietet, sipas zonave gjeografike ku është kultivuar. Kjo s'ka të bëjë me tokën, ka të bëjë me vreshtin, por edhe me tokën në pozicionet gjeografike. Për shembull, duhet të dihet se qarku i Beratit duhet të dijë se sa hektarë ka në prodhim, sa bimë janë për verë dhe sa është prodhimi total që ne ta dimë se, në qoftë se Berati prodhon 100 mijë shishe, në qoftë se ka 110 mijë, këto nga kanë ardhur? Kadastrimi e saktëson çështjen e sasisë dhe të cilësisë së verës. Kjo është edhe për verërat e importit. Në qoftë se nuk i vëmë një kuotë një vere që futet, ai kur vjen herën e dytë,

duhet t'i përmbahet kësaj cilësie që ka sjellë herën e parë, nuk duhet të ndryshojë cilësia me atë që ka deklaruar. Këtu shikohet një disnivel i cilësisë, i cili lë për të dëshiruar.

Ne kemi bërë disa sondazhe dhe, nga verërat e importit që futen, vetëm 10% mund të jenë cilësore, se të gjitha janë jashtë standardit.

Ligji ynë duhet të bëjë një klasifikim cilësor, të cilësisë së verës sipas rajoneve dhe sipas treguesve gjeografikë, duke bërë që për konsumatorin tonë ne të jemi të konkurrueshëm, se aktualisht është një hendek shumë i madh sa i përket cilësisë së verërave, sepse nuk kanë një klasifikim të drejtë të cilësisë. Mjafton një prodhues që thotë se kam një vresht, kam një NIPT të thjeshtë dhe thotë se unë prodhoj verën më të mirë. Ai i vendos emrin verës, por se çfarë përmban konkretisht nuk shënohet. Duhet një klasifikim cilësie.

Arben Pëllumbi – Si e kemi sot ne këtë? Çdolloy lëngu që ka ngjyrë, del në treg dhe quhet verë?

Gazmend Shehi – Ligji i vitit 1999 ka një përshkrim teknik për të thënë të drejtën. Fermentimi i lëngut të rrushit të freskët quhet verë. Unë po flas për emra tregtarë. Ti i vendos emrin verës dhe mund të dalësh në treg. Unë mendoj se duhet të kalojë patjetër në analiza fiziko-kimike dhe në panelin shkencor të shijimit pastaj t'i marrin emërtimet dhe verërat të kalojnë në treg. Unë mendoj se kjo do të jetë paralelisht edhe për verërat e importit, duhet të jetë i njëjti standard edhe për to.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Urdhëroni, zoti Gështenja!

Lefter Gështenja – Faleminderit!

Faleminderit për sqarimin, zoti Shehi!

Unë kam një pyetje: a kemi sot ne një institucion, meqenëse nuk jam i fushës, që na e konfirmon apo certifikon produktin, pra verërat që dalin në treg?

Faleminderit!

Roland Dama – Jam inxhinier kimist, pjesë e shoqatës së verërave familjare nga rajoni i Jugut, Përmeti, njëkohësisht, edhe anëtar i KASH-it.

U bashkohem të gjitha shqetësimeve të parafolësve, por në veçanti, duke pasur parasysh se cili është përfundimi i çdo projektligji kur bëhet ligj që realizon detyrimet madhore, zhvillimin e rajonit ose zhvillimin e sektorit përkatës, do të thosha në lidhje me këtë ligj, me aq përvojë sa kam, se këtu ka disa nene, të cilat në momente të caktuara kundërshtojnë njëra-tjetrën, ka edhe disa paqartësi në shumë emërtesa që bëhen, ka edhe një terren konkret që për një afat dyvjeçar unë mendoj se do të jetë e vështirë. Ne kemi investuar

dhe kemi një jetë që investojmë, 30 vjet, dhe nuk na vjen mirë që të mos mbrohet ky investim 30-vjeçar.

Kemi një përplasje këtu që do të dalë produkti në treg, por produktet që vijnë nga parcela të vogla 0,5 hektarësh, që shmangen në disa pika për pajisjen me certifikatat përkatëse, nuk dalin në treg sipas neneve përkatëse, por unë do të thosha që kjo është masive. Besoj se 80%-90% e prodhimit vendas është një prodhim i vogël, siç jam edhe unë, ndoshta jo te përmasa e 50 hektolitrave, diçka më tepër, por kjo është ajo që mbulon totalisht tregun në Shqipëri dhe këto investime janë.

Unë shoh që të mendohet për ta orientuar të gjithë këtë biznes në këtë hapësirë dyvjeçare. Çfarë do të bëhet me këtë pas 2 vjetësh? Unë them se nga 90% që jemi ne, edhe unë që mendoj se mund ta realizoj, kam frikë se nuk e realizoj dot nëse nuk shoh edhe orientimin, nuk shoh institucionet përgjegjëse që do të merren me sqarimin e kësaj, nuk shoh edhe hapat mbështetës për këtë, sepse të flakim investimin 30-vjeçar që, realisht, ne e kemi parë që ka raste të tilla, edhe në politikat që zhvillohen, atëherë i bie që ne të mos kemi shpresë.

Unë do të thosha se këtu ka shumë hapësira. Njëkohësisht, diçka që ky ligj lë mangët, me aq përvojë sa kam unë edhe nga vendet jashtë, është pjesa e distilimit. Ka një nonsens të disa pikave, të disa neneve që e lënë të pasqaruar problemin e mbushjes së materialeve me përqendrimin e sheqerit apo me mbushje me alkool. Nga do të vijë ky alkool? Kjo lihet evazive.

Po të heqim edhe këtë që shumë kantina të vogla mbahen me të dy elemente, me verën dhe me rakinë, atëherë i bie që ne rakinë e kemi që na zbut kostot. Këtu kemi arritur se, realisht, rakia që shitet (kryesisht ne shesim shumë pak) është informale, fshatarët e bëjnë vetë. Në këtë mes, po i hoqe edhe distilatet, kazanët e thjeshtë, atëherë na vret.

Unë këto do të shtoja, përpos gjithë të tjerave që përmendën zotërinjtë.

Për sa i përket pjesë së eksportit, që ne ta realizojmë atë, këtu lihet në mënyrë evazive tek aktet nënligjore, por parimisht duhet të përcaktohet korniza në ndërhyrjet që duhet të bëjnë ne rrush për të ruajtur stabilitetin nga viti në vit të verërave, sepse një vit rrushi piqet, një vit nuk e arrin dot siç duhet. Unë kam qenë në Francë dhe atje kishte toleranca deri në 2 gradë alkooli, jo 2 gradë në 2 gramë sheqer. Këto kam vërejtur unë si specialist.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Unë ju kërkoj ndjesë, se ndoshta personalisht nuk ju njoh të gjithëve.

Urdhëroni!

Rigers Kaçorri – Përshëndetje!

Jam përfaqësues i kantinës “Arbri”. Ne jemi një grup të rinjsh për sa i përket pjesë së prodhimit, jemi të gjithë të profesionit, pra jemi të shkolluar jashtë për pjesën e enologjisë. Jemi rreth 7-8 kantina. Nuk po flas për pjesën e prodhuesve familjarë, por për pjesën e prodhuesve të sektorit që kanë diku te 30-40% të gjithë prodhimit kombëtar për sa i përket verës standarde për sa i përket ligjit që është momentalisht në fuqi.

Për sa i përket projektligjit, ne si grup të rinjsh nuk kemi shoqatë momentalisht, por jemi mbledhur të gjithë bashkë, sepse besojmë se ka nevojë për pak më shumë kohë për sa i përket këtij ligji.

Ne kemi pasur mbështetjen maksimale të ministrisë. Ky projektligj ka filluar që para dy vjetësh, në vitin 2020, nga zoti Çuçi kur ishte ministër dhe ka vazhduar gjatë këtyre kohëve duke pasur ndryshime thelbësore në draftet e tij, sepse nga drafti i parë, deri në draftin që ne kemi sot të propozuar, ka ndryshime shumë të mëdha dhe, realisht, është bërë një punë shumë e mirë.

Për sa u përket pikave, mendojmë se ka disa pika që janë shumë të rëndësishme, sepse ne e prekim përditë realitetin e sektorit dhe, përveç tregut vendas, ne eksportojmë në shumë vende të BE-së, edhe në USA.

Për sa i përket projektligjit, më duhet të ndalem në disa pika që mendoj se janë të realizueshme, sepse duhet një përafrim i moderuar me pjesën e BE-së, kundrejt direktivave, por mos të harrojmë se secili nga shtetet e BE-së në shtetin e vet përdor rregullat e vendit të vet. Ne këtu kemi një përplasje për sa u përket rregullave të BE-së me rregullat e secilit shtet.

Është shumë e rëndësishme të merret pjesa teknike. Sot që flasim, pjesa teknike, unë bashkë me përfaqësuesit e Ministrisë, kemi kërkuar që të bëhet një mbledhje e informacioneve që realisht nuk janë të gjitha dhe krijimi i një grupi prej 2-3 anëtarësh që janë specialistë të fushës. Pra, në rang të BE-së, sot kemi enologë me një emër shumë të mirë dhe janë përfaqësues për të drejtën e verës dhe të pijeve alkoolike. Kjo është gjë shumë e mirë.

Sot kemi ligjin e vjetër dhe realisht mundësia e sektorit të verës është shumë e madhe, sepse kemi varietete autoktone shqiptare shumë të mira, të paktën 7 që ne i dimë se janë varietete autoktone dhe nuk duhet të bëjmë gabimet që kanë bërë shtetet e tjera që kemi afër.

Pjesa e ligjit për sa u përket termave që sot kemi, një ndër pikat janë treguesit e origjinës dhe pjesa e emërtimit të origjinës, gjë që sot do shumë kohë që të realizohet. Po ju marr një shembull me pjesën italiane. Po të marrim zonën e Kiantit. Unë kam një draft që është diku te 10 faqe dhe ka të përcaktuar me milimetra pjesën e zonave nga ku vjen varieteti. Pra, varieteti vjen nga kjo zonë në këtë zonë dhe është totalisht gjithçka e mirorganizuar,

ndërkohë në ligjin që ne kemi krijuhet institucioni, pra janë dy institucione, për sa i përket edhe emërtimit të origjinës dhe treguesve gjeografikë, por ne nuk kemi të ndarë akoma zonat. Pra, pjesa e ndarjes së zonave është gjë shumë e rëndësishme, sepse, në qoftë se ky ligj do të miratohet, këto zona mblidhen dhe disa prodhues futen dhe marrin këtë pjesë të treguesve gjeografikë dhe plotësimeve të saj, por ndodh që pjesa e prodhuesve të vegjël, fermerët, pjesa e prodhuesve që vetëm shesin, për shembull, rrushin, ose edhe ne që kemi vreshtin tonë, mund të lëmë të parapërcaktuar pjesën e prodhuesve që duhet të jenë pjesë e këtij konsorciumi ose shoqate.

Në qoftë se kjo shoqatë mblidhet dhe formon ose, le të themi, ka pjesën e këtyre treguesve dhe mbrohet siç është sot në ligj nga DPPI-ja që është marka, pjesa më e madhe e sektorit ose zonat që ne nuk i dimë sot, dalin jashtë këtij funksioni, prandaj është shumë e rëndësishme pjesa e zonimit.

Ne vërtet jemi specialistë të fushës, por ne kërkojmë më shumë, por normalisht ministria duhet të na japë sportin për sa i përket pjesës teknike, anës juridike, sidomos, sepse ligjet ndryshojnë dhe kanë disa lloje pikash.

Arben Pëllumbi – Unë doja të dëgjoja mendimin e ministrisë për këtë çështje. E kemi sot zonimin? Nëse nuk e kemi, a mund ta bëjmë?

Julinda Bare – Pjesa e zonimit, që është pjesa kryesore që ka ngritur edhe grupet e prodhuesve është futur në ligj, është neni 10, pika e fundit, që me VKM, në bazë të një studimi, do të miratohen zonat e vreshtarisë.

Prodhuesit e kanë kërkuar dhe ne e kemi bërë pjesë të ligjit. Dua të bëj edhe një sqarim, sepse ligji që ne kemi në shqyrtim prek treguesit gjeografikë, por nuk është objekt thelbësor i këtij ligji.

Treguesit gjeografikë të verës janë rregulluar me ligjin e pronësisë industriale, amenduar së fundi, si dhe me ligjin e skemave të cilësisë. Pra, janë dy koncepte të ndryshme. Ky ligj rregullon nga ana teknike sektorin e vreshtarisë dhe verës, ndërsa pjesa e treguesve gjeografikë, pasi janë pronësi intelektuale, ka të bëjë me ligjin e pronësisë intelektuale, i cili, bazuar në rregulloret e BE-së, është amenduar dhe është plotësisht i përditësuar, i përafuar.

Ky ligj përcakton dhe bën lidhjet midis ligjit të pronësisë intelektuale. Ligjit të skemave të cilësisë dhe këtij ligji. Pra, në ministri do të ngrihet një komision, sipas dispozitave të këtij ligji, me përfaqësues me bazë të gjerë me eksperiencë të përcaktuar që do të bëjë vlerësimin e specifikimeve teknike për t'u regjistruar si tregues cilësie. Pra, nuk është objekt i këtij ligji treguesi gjeografik.

Kam edhe një gjë tjetër me kadastrën për ta sqaruar edhe Gazin.

Kadastra e vreshtarisë është ngritur me një projekt të BE-së, me të gjithë cilësitë që BE-ja kërkon, me një projekt që në vitin 2008, që është bërë funksional dhe ka filluar nga viti 2010. Në vitin 2019 ka përfunduar regjistrimi i të gjitha sipërfaqeve të vreshtave që ne kemi, rreth 7300 ha, por me kushtin të regjistruar mbi 1000 metër katror dhe që nga viti 2019 ka filluar përditësimi dhe regjistrimi i të gjitha sipërfaqeve që janë nën 1000 metër katror.

Ne po punojmë paralelisht edhe me përditësimin dhe shtimin e moduleve në këtë kadastrë.

Aktualisht, kadastra që ne kemi ka të regjistruar të gjitha sipërfaqet e vreshtave në të gjitha qarqet e vendit, ka të regjistruar sipërfaqen e tokës, përmes një sistemi GIS, si emrat e pronarëve, varietetet, shtrirjen dhe prodhimin. Pra, ne jemi në përfundim të plotësimit të të gjithë bazës së një kadastrë të mirëfilltë për verën. Ajo që ky ligj rregullon është që edhe vetë prodhuesit do të bëjnë deklaratimet vjetore të prodhimit dhe të shitjes, të cilat do t'i shtohen kadastrës së vreshtarisë.

Arben Pëllumbi – Mua, personalisht, por besoj edhe gjithë kolegëve ju erdhi mirë kur dëgjuan se ky është një nga projektligjet e debatuar dhe të diskutuar më shumë se sa çdolloj projektligj tjetër. Më erdhi shumë mirë që e dëgjova këtë gjë.

Gjithsesi, prapë shikoj një kontradiktë në deklaratimet mes dy palëve. Përfaqësuesit prodhues kanë një shqetësim për kadastrën, kanë edhe një shqetësim për origjinën e zonës. A nuk e keni gjetur dot këtë akord? Se besoj që nuk ky vendi ku ju mund të sqaroheni.

Julinda Bare – Unë mendoj që në konsultimet që kemi pasur, të cilat kanë zgjatur më shumë se dy vjet, janë sqaruar dhe janë diskutuar në detaje të gjitha. Ajo që është kërkuar plus zonimit, të cilin ne e kemi përfshirë, është që ministria të luajë rolin e hartuesit të specifikimeve teknike në momentin e regjistrimit të treguesve gjeografikë. Kjo është kërkuar nga prodhuesit. Kjo nuk është pjesë e këtij ligji. Ne po punojmë me rrjetin rural të zhvillimit rajonal që kemi me ekspertët rajonalë për të mundësuar, në momentin pas zonimit, specifikimet, karakteristikat e varieteteve për çdo zonë të vreshtarisë. Pra, do të vazhdojmë të jemi në ndihmë të prodhuesve për të përcaktuar karakteristikat e produktit. Por, sipas legjislacionit aktual për treguesit gjeografikë, duhet të jenë vetë prodhuesit që duhet të përcaktojnë karakteristikat e produktit të tyre. Ne me ekspertë do t'i ndihmojmë, pavarësisht se këta janë të gjithë ekspertë, për të dalë një produkt cilësor, por janë vetë prodhuesit që duhet të plotësojnë karakteristikat dhe duhet të shënojnë çfarë ata duan që të ketë produkti i tyre.

Të gjitha këto janë diskutuar dhe unë nuk e di pse janë rikthyer përsëri. Në dafllig janë të plotësuarat kërkesat që nga zonimi me studim, që nga komisioni konsultativ i vreshtarisë dhe nuk di pse ngrihen të njëjtat shqetësime.

Megjithatë, ne do t'i rishikojmë të gjitha edhe një herë.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Shehi!

Gazmend Shehi – Pa dashur ta kundërshtoj kolegen, mendoj se është një mënyrë evazive, në qoftë se deklarohet vetë, sepse ajo ka attribute, pozicioni gjeografik, numri i bimëve për hektar, pra ka disa kritere dhe këto duhet të parashikohen në ligj. Këtë duhet ta bëjë një institucion i pavarur, nuk mund të lihen me vetdeklarim.

Ky është opinioni ynë. Po të marrim një shembull të thjeshtë, ta marrim Shqipërinë vetëm një rajon dhe unë kam kantinë dhe them se më pëlqen Vranaci i Maqedonisë. Po e marr, por e provoj dhe po i vë edhe etiketën “prodhim shqiptar”, por çfarë do të bëjnë këta të tjerët? I njëjti problem është edhe brenda. Unë mund të blej një varietet që bëhet në Berat dhe ta bëj unë në Tiranë. Kjo nuk shkon, se duhet që më përpara të kufizohet harta gjeografike në ligj dhe këtë e bën kadastrimi.

Ne e kemi shumë të thjeshtë, por mendoj se duhet vetëm të kuptohemi.

Ka edhe studime në këtë sektor për sa i përket vreshtarisë, sipërfaqes së vreshtave dhe verës që prodhohet sipas çdo rajoni. Më pas, në bazë të kësaj, ne jemi korrektë edhe me çfarë prodhojmë si sasi, edhe si cilësi. Jemi edhe të monitoruar. E kontrollojmë komplet sasinë dhe origjinën e produktit. Por në këto kushte është pak evazive. Mendoj se përbën hap kryesor kadastrimi dhe përcaktimi i rajoneve.

Më përpara këtu ka qenë bërë një studim, ku ndarja bëhej sipas pozicionit gjeografik të çdo rajoni, në bazë të metrave mbi nivelin e detit. Edhe ajo mund të merret parasysht, por ne kemi propozuar që të bëhej një ndarje siç e kanë disa vende, si për shembull Italia. Kemi propozuar: Shqipëria Qendrore, Shqipëria Verilindore, Shqipëria Jugore, domethënë tre katër rajone. Në bazë të këtyre rajoneve të ndahet harta gjeografike. Në këtë hartë janë prodhuesit, sasia e vreshtave dhe mbaron kjo punë. Por mendoj se kjo duhet përcaktuar në ligj.

Zoti Kaçorri, mund të vazhdoni!

Rigers Kaçorri – Atëherë, jam plotësisht dakord me kolegun. Realisht, disa dispozita janë të qarta, por për pjesën e veprimit ose për pjesën e realizimit, mendoj se është e pamundur. Po marr vetëm një shembull të thjeshtë: Kallmetin, në zonën e Veriut. Mendoj se Ministria e Bujqësisë, përveç termave tradicionale që ka, nuk ka asnjë lloj specifikimi për varietetet autoktone shqiptare. Varietetet autoktone shqiptare përbëjnë pasuri kombëtare,

sepse janë një pasuri e të gjithëve. Pra, po flas për pjesën veriore, siç është Kallmeti. Kallmeti është në zonën e Mirditës, kufiri Shkodër-Lezhë, që janë Kallmeti dhe Fishta, por është edhe pjesa e Shtoit në Shkodër. Pra, kjo është një zonë, e cila përcaktuar para shumë vitesh nga Universiteti Bujqësor. Janë edhe vreshta të universitetit, por edhe të zonës, që kanë qenë edhe para viteve '90, që janë edhe sot.

Tani, çfarë ndodh? Për të krijuar këtë denominacion ose këtë shoqatë, mendoj unë, me draftin që kemi, është e pamundur që të bëhen bashkë të gjithë prodhuesit e asaj krahine ose e atyre vreshtave që janë. Pse? Sepse pjesa e sipërfaqes është e ndryshme. Për shembull, ne kemi një vresht 500 metra mbi nivelin e detit, një tjetër 20 metra mbi nivelin e detit, një tjetër akoma 200 metra mbi nivelin e detit. Është shumë të rëndësishme të bëhen këto klasifikime, sidomos pjesa e kooperimit. Pra, në qoftë se unë kam sot rreth 50-60 fermerë që bashkëpunojnë, unë nuk mund t'u them: ejani të bëheni pjesë e këtij organizmi. Pra, duhet gjetur një lloj forme, që ky kooperim të jetë sa më fleksibël, që të bëhet gjithëpërfshirës. Vazhdoj të mendoj se pjesa e regjistrimit të markës duhet t'i mbetet ministrisë. Pra, ideja është se në momentin e parë që u krijua shoqata, u krijuan të gjitha, por pjesa e markës nuk mund t'i mbetet shoqatës, mendoj unë, sepse ne akoma nuk e kemi kulturën e bashkëpunimit me njëri-tjetrit. Në qoftë se marka mbrohet nga dikush, është prona e tij, është prona e asaj shoqate. Ne kemi kërkuar që të jetë ministria, pra kjo markë të jetë pronë e ministrisë. Mund të jetë edhe një përfaqësues i ministrisë, i cili ka të drejtë ekskluzive, që edhe ta menaxhojë këtë gjë. Unë mendoj se kjo është diçka që momentalisht mund të realizohet. Mbase jo në kohë shumë të gjatë, por mund të realizohet.

Arben Pëllumbi – Zoti Kaçorri, ju më thatë se keni një eksperiencë në Itali, ku dhe keni studiuar.

Rigers Kaçorri – Po.

Arben Pëllumbi – Ne nuk kemi pse shpikim rrotën. Ne kemi në krah një nga shtetet më të fuqishme në këtë sektor. Si e kanë të organizuar ata? Sepse, besoj se edhe projektligji ynë është mbështetur diku, apo jo?

Rigers Kaçorri – Po marr vetëm një shembull. Kam disiplinarin e zonës së Chianti-t, që është *denominazione di legge controllata e garantita*. Aty thuhet që pjesa e zonave klasifikon llojet e varieteteve të rrushit, që është diçka shumë e rëndësishme, pasi këto lloj varietetesh duhet të klasifikohen. Po ashtu, për secilën zonë ka të specifikuar pjesën e zonës. Pra, është zona e Chianti-t, që është më e madhja, pastaj është *Chianti Superiore*, *Chianti Ruffino*, *Chianti Tregole*, pra ka disa kategori, që janë gjithmonë brenda kësaj zone. Ne këtë kemi kërkuar, që të pjesa kryesore. Normalisht, të mos kalojë te pjesa e mbrojtjes, sepse

pastaj do të përfundohet në mosdakordësi nga ana e prodhuesve të vegjël, por edhe nga ana e prodhuesve të mëdhenj. Pra, të gjendet një formë, normalisht duhet ta gjejë ministria, që për këtë lloj enti që do të ngrihet, leva kryesore të jetë ministria.

Arben Pëllumbi – Me çfarë po kuptoj unë, ju po kërkoni një ent, i cili të jetë publik, por të mos jetë privat.

Rigers Kaçorri – Po.

Arben Pëllumbi – Për herë të parë kjo, sepse në përgjithësi i duan private, jo publike.

Rigers Kaçorri – Realisht, është shumë e rëndësishme, sepse gjërat duhet të marrin kohën e vet.

Arben Pëllumbi – Që të kuptojmë pak më mirë, meqë më folët për Kallmetin, dhe thatë se është një nga tre zonat e Shqipërisë: në qoftë se mua më mbushet mendja që ta bëj këtu Kallmetin këtu, në Shesh, a më lejon ligji? Ose, nëse më lejon, çfarë duhet të kem parasysh? Kjo që ta kemi të qartë.

Rigers Kaçorri – Nuk e merr dot emrin “Kallmet”.

Arben Pëllumbi – Por mund të quhet “Kallmet i Sheshit”.

Rigers Kaçorri – Jo, ti do të kesh një lloj vere të kuqe, por nuk do mund t’i vësh emrin “Kallmet”. Kjo sepse “Kallmeti” është vetëm në atë zonë.

Pra, kjo është gjëja e rëndësishme që ne kërkojmë. Siç është, për shembull, “Vlosh” i Vlorës. “Vloshi” i Vlorës prodhohet në Vlorë dhe është tipik vetëm në atë zonë.

Arben Pëllumbi – Po në qoftë se do të donit ta merrnit ju “Vloshin”?

Rigers Kaçorri – Nuk e marr dot.

Arben Pëllumbi – Pse, nuk të lejon ligji, nuk të lejon ministria?

Rigers Kaçorri – Me këtë që është, e lejon, ndaj ne duhet ta përcaktojmë. Pra, ideja është se pjesa e patentave ka shumë rëndësi. Siç kemi patenta të gjithë ne...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Julinda Bare – Edhe një herë: pjesa e zonimit dhe e përcaktimit të karakteristikave, që thotë Gersi, është e përcaktuar në nenin 11, me studim të zonave. Ky studim do të bëjë detajimin e zonave, karakteristikat, varietetet, llojet e produkteve e të gjitha me radhë, çfarë i përket sektorit të vreshtarisë e të verës. Lidhur me treguesit e cilësisë, treguesit e cilësisë nuk janë markë, por dallim. Kur flasim për markë, flasim për markë, kur flasim për tregues cilësie, flasim për tregues emërtim origjine dhe tregues gjeografikë, që janë dy gjëra komplet të ndryshme. Referuar ligjit që ju përmendët, këto nuk janë pjesë e tij. Ai ligj ka përfunduar. Sipas Rregullores së BE-së, treguesit gjeografikë janë përafruar te ligji “Për pronësinë intelektuale”, sepse emërtimet e cilësisë janë pronësi intelektuale. Sipas legjislacionit,

ministrria nuk mund të jetë pjesë. Ministria mund të ndihmojë, sikundër po punon me regjistrimin e produkteve me tregues emërtimi, me djathin, për shembull, me mishavinën, me djathin e zierë të Malësisë së Madhe, me mjaltin e Bedunicës.

Ministria harton, ndihmon grupet e prodhuesve për të përfituar këtë emërtim, por ajo nuk mund të jetë pjesë, sepse sipas legjislacionit, që është i detajuar për verën, janë vetë prodhuesit ata që vendosin se cilat janë karakteristikat që duhet të plotësojë produkti i tyre, për të marrë këtë vulë dhe këtë emërtim cilësie. Në rastin e Kallmetit, ligji thotë se duhet të jetë një grup prodhuesish për t'u regjistruar me emërtim origjine. Mund të jetë edhe një individ, nëse i plotëson të gjitha kushtet. Pra, nëse në atë zonën nga Lezha deri sipër në Mirditë nuk ka asnjë prodhues tjetër të Kallmetit, i cili plotëson ato specifikime, Arbri mund ta regjistrojë te konsorciumi italian, mund ta regjistrojë Gjoka e kështu me radhë. Sa i takon pjesës së “Vloshit” të Vlorës, që ju e përmendët, Arbri nuk mund ta regjistrojë verën e “Vloshit”, pasi është karakteristikë e zonës së Vlorës.

Të gjitha këto zonime dhe karakteristika do të përcaktohen tek studimi që kemi parashikuar në këtë ligj, por pjesa e treguesve të cilësisë është e detajuar, e sqaruar në ligjin “Për pronësinë intelektuale”, sa u takon kushtet që duhet të plotësojnë.

Arben Pëllumbi – Zoti Kaçorri, a jeni të njohur ju me këto që thotë zonja Bare?

Rigers Kaçorri – Pjesa e dytë, që realisht do të bëhet, nuk e dimë si do të ndodhë, prandaj po parashtrijmë idenë që të bëhet kjo gjë. Ideja është: më mirë të harxhojmë pak më shumë kohë me këtë ligj, që të bëhet një punë e saktë, duke i bërë këto përkufizime, sepse siç e thashë edhe më herët, varietetet janë të të gjithëve. Pra, në një moment që krijohet një konsorcium, një shoqatë ose një SHBB, mbase do të jetë i vështirë bashkëpunimi midis prodhuesve. Prandaj, për të mos ardhur deri aty, ne synuam të gjejmë një formë, që të ketë një kooperim, një bashkëpunim, duke pasur si gjë të parën fare pjesën e ministrisë, pra duke na orientuar ministrria që kjo të gjendet për një periudhë kohe. Kjo është pjesa më e rëndësishme. Pastaj, normalisht, specialistët do të bëjnë punën e tyre, sepse normalisht ministrria do të ketë specialistë të detajuar të sektorit, të cilët do të mund ta shikojnë me përparësi.

Për sa u përket pikave të tjera, disa prej tyre duhen parë, si pjesa e produkteve enologjike, pra pjesa e shtesave që bëhen në verë, që ligji i Bashkimit European e ka të detajuar. Normalisht, ne e kemi marrë pak a shumë si pjesa e Bashkimit European, por nuk kemi përkufizimit specifike. Bashkimi European ka disa lloj specifikimesh, por secili nga shtetet ka përkufizimet e veta. Nuk besoj se ne kemi një tabelë apo një informacion në lidhje me këto specifikime, që janë shumë të rëndësishme, sepse lidhen me pjesën e etiketimit dhe

me konsumatorin, pra me pjesën shëndetësore. Ne kemi sot përkufizimet: tradicionale, bio, biodinamico, pra disa lloj përkufizimesh, që realisht mendoj se sot duhet të shikohen. Po marrim një shembull: pjesa e SO₂-shit, që janë shtesat në verë, solfitet, fjala vjen, që e kemi të detyruar me ligj ta shkruajmë, që është ligji i etiketimit nga AKU-ja. Për shembull, bio është 150 miligram për litër, ndërsa jo bio është 188. Por nuk e bën ndryshimin ai tridhjetëshi. Pra, këtu duhet të kemi një tabelë, një draft, që t'i shikojmë këto shtesa. Mora një shembull shumë të thjeshtë, që përdoret në gjithë Europën, në të gjithë botën. Janë edhe disa elemente të tjera, që ne do t'i shikojmë.

Pak më parë, Gazi foli edhe për pjesën e importit. Kur ne bëjmë një eksport, kemi një sërë dokumentesh në lidhje me eksportin: Dhoma e Tregtisë, certifikata të ndryshme, analizat e kështu me radhë. I kemi kërkuar ministrisë diçka që është shumë e realizueshme, mendoj unë: që përveç certifikatës që marrim nga Dhoma e Tregtisë, të bëhet një certifikatë nga AKU-ja. Sepse ne i bëjmë analizat gjatë gjithë kohës, miratojmë etiketat, bëjmë analizat e verërave, bëjmë analizat e produkteve, bëjmë analizat gjashtëmujore e të gjitha me radhë. Megjithatë, duhet bërë një certifikatë, sepse gjatë gjithë kohës, kur produkti ynë del jashtë kufijve të Shqipërisë, has në problematika doganore. Ai doganieri atje nuk e merr. Pra, duhet të bëhet unifikimi i një certifikate ose i dy dokumenteve, që i kemi për eksportin. Po ashtu, është edhe pjesa e ligjit, që e kemi diskutuar bashkë me Albanin, dhe realisht kemi bërë disa ndryshime, edhe për pjesën e importit. Pra, deri para pak kohësh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po marr një shembull: çdo person juridik ose fizik, mjafton të ketë një NIPT, ka të drejtë të importojë në Republikën e Shqipërisë, gjë që është totalisht e padrejtë. Në gjithë Bashkimin Europian, por edhe në Ballkan, të gjitha kompanitë e importit duhet të licencohen. Minimalisht, ne u kemi kërkuar një licencë në çdo tre vjet. Pra, të kemi një listë të këtyre kompanive, sepse ne s'e dimë sa janë, çka se në dijeninë time sot janë të paktën 250-300 importues. Së paku me sa informacion kam unë. Nuk jemi kundër, sepse të gjithë jemi dashamirës të verës, të gjithë kemi dëshirë të prodhojmë verëra të ndryshme, por jo çdo lloj personi që ka një NIPT mund të importojë në Republikën e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka, sa i përket anës doganore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga ana e akcizës, janë verëra me 12 -12, 5, 10, 5, janë verërat me gaz. Ka disa lloj specifikimesh, sa i takon alkoolit. Megjithatë, duhet të shikohen, sepse është shumë e

rëndësishme. Jo pse ne jemi kundër, por duhen parë me përparësi, gjë që mund ta bëjë specialisti.

Arben Pëllumbi – Ka diçka zoti Mziu.

Xhelal Mziu – Falemnderit!

Së pari, më vjen mirë që produkti i verës ka filluar të bëhet konkurrues në Shqipëri. Ndonëse nuk jam i kësaj fushe, shoh se disa shqetësime mund të zgjidhen, qoftë edhe me këtë projektligj. Pavarësisht se me vonesë, ka pasur një angazhim, kanë filluar të evidentohen ca produkte, por që prapë janë larg vendeve të rajoni, madje dhe larg Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë. Edhe pse kanë kaluar tridhjet vjet demokraci, nuk po i konkurrojnë dot këto verëra.

Shqetësimi im, por që jam i bindur se mund të jetë edhe shqetësimi juaj, ka të bëjë me faktin nëse janë referencat mbështetëse të qeverisë në Shqipëri ashtu si në vendet e rajonit, në lidhje me mbjelljen e vreshtarisë e me subvencionimin e produktit që merret; pra nëse ka diferenca midis një prodhuesi vreshtarie dhe vere në këto tre vende të rajonit, në raport me Shqipërinë. Cili është shqetësimi juaj, që mund të gjejë vend për evidentim? Së pari.

Së dyti, zonimi ose përcaktimi i varieteteve sipas zonave ku duhet të prodhohen. Bazuar në një eksperiencë të thjeshtë, që kemi pasur kur kemi shkuar në Itali, atje shteti shkonte dhe përcaktonte edhe se cili varietet duhej të mbillej në anën lindore të një kodre, cili në anën jugore apo perëndimore. A është shqetësim për ju mbështetja nga ana e shtetit, për të përcaktuar këto zona, se cilat janë varietetet? Njëpërmjet kësaj kryhen dy veprime: së pari ruhen varietetet autoktone, së dyti nuk e lejojmë prodhuesin të shkojë e të mbjellë më kot një varietet, pa e ditur nëse prodhohet apo jo aty. Pra, A është shqetësim për ju, që qeveria ose ministria nuk kanë bërë zonimin e tyre?

Problemi i tretë. Më vjen mirë që kemi një enolog, i cili ka studiuar në Itali. Unë, së paku duke qenë edhe në Universitetin Bujqësor, di që ka një shqetësim edhe tek vetë dekanati i Hortikulturës dhe i Vitikulturës, që këto ditë po mbyllen degë shumë të rëndësishme, ndërkohë që ne pretendojmë zhvillimin e këtij sektori shumë të rëndësishëm dhe të gjithë bujqësisë. A nuk është shqetësim për ju, po ndërkohë edhe për ministrinë, që të gjejë indikatorë për t'i mbështetur këta sektorë shumë të rëndësishëm, që ju të mos prisni të merrni persona që shkojnë për të studiuar jashtë, por të merrni këto burime njerëzore që janë brenda? Pra, unë e shoh si element shumë të rëndësishëm, që në perspektivë ndoshta do të ketë një vakuum të jashtëzakonshëm, dhe Universiteti Bujqësor ka kapacitetet e nevojshme intelektuale, profesionale, për të nxjerrë specialistë të këtyre fushave. A nuk do të ishte mirë që edhe njëpërmjet këtij ligji, duke qenë edhe ju palë shumë e rëndësishme, të vendosen ca

stimuj qoftë për studentët, qoftë për mbështetjen që mund t'i jepet Universitetit Bujqësor, por dhe për certifikimin e këtyre zonave në lidhje me verërat?

Një element tjetër, në lidhje me të cilin unë bie ndesh me ju, pra jam kundër, është monopoli që ju doni të krijoni në aspektin e importit. Duke marrë shkas nga kriza në të cilën ndodhemi sot, vetëm në Shqipëri ka shkuar vaji tre herë, pesë herë më shumë se sa para krizës, madje dy herë apo tri herë më shumë se sa në Angli. E gjithë kjo ka ndodhur për shkak të monopolit. Unë jam absolutisht kundër monopolit. Pavarësisht prirjes që kam për të përdorur një verë shqiptare, vë re se çmimi dhe shija e verës shqiptare në raport me një verë italiane apo një verë të Malit të Zi, ka diferenca të theksuara. Pra, unë nuk jam për të krijuar monopol për importuesit, sepse do të na vijë si puna e plehut kimik, nitratit, superfosfatit apo vajit. Kjo nuk do të thotë që ato të mos kalojnë filtrin ligjor apo filtrin e cilësisë së produktit.

Tjetër shqetësim, që mund të gjejë zgjidhje ka të bëjë me produktin *Made in Albania*. Qeveria mund të gjejë instrumente qoftë duke stimuluar resortet e ndryshme, që po krijohen, duke i nxitur apo duke u imponuar që turistët e huaj, por edhe ata vendës, ta përdorin më shumë produktin *Made in Albania*.

Unë u mundova të paraqes disa nga gjërat, që ju mund t'i dini më mirë, në lidhje me të cilat mund të ushtroni ndikimin tuaj për t'i adresuar në këtë projektligj apo dhe për të ndikuar te qeveria, që ka të bëjë, po themi, me studentët apo burimet njerëzore, që të mund të mbështeten nga shteti.

Falemnderit!

Fadil Nasufi – Falemnderit, zoti Mziu!

Kush do të japë ndonjë shpjegim në lidhje me këto parashtrime që bëri zoti Mziu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, sa të japë përgjigje për këto.

Zoti Kaçorri!

Rigers Kaçorri – Për sa u përket pyetjeve të zotit Mziu, për pjesën e produktit *Made in Albania*, unë mendoj, por besoj se edhe pjesa e prodhuesve, se është një produkt i veçantë në llojin e tij. Kjo do të thotë se të gjitha vendet e rajonit kanë produkte ose, më saktë, varietete internacionale, duke filluar nga Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Mali i Zi, ndërsa produktet tona janë kryesisht nga kantinat tona, që prodhojnë produkte me varietete autoktone shqiptare, siç është Kallmeti, Sheshi i Bardhë, Sheshi i Zi, Pulsi i Beratit, Vloshi i Vlorës dhe Bina e shumë varietete të tjera.

Pra, te pjesa e produktit “*Made in Albania*” mendoj dhe besoj se jemi në rrugën e duhur dhe po e vërtetojmë punën e profesorëve të nderuar të Universitetit Bujqësor, që ka

qenë vite më parë. Për këtë mendoj se nga ana e ministrisë kemi pasur realisht suportin më të mirë, sepse ka pasur mbështetje për pjesën e mbjelljes, si dhe sot ka mbështetje për mbjelljen e varieteteve autoktone dhe atyre ndërkombëtare. Pra, ka subvencione nga AZHBR-ja gjatë gjithë kohës dhe është realisht, besoj unë, në rrugën e duhur.

Më ngacmoi pak fjala përpara që thatë për pjesën e monopolit. Ky ligj në vetvete nuk ka asnjë lloj karakteristike që të krijojë një monopol, përkundrazi, thjesht është një rregullator, pra rregullon pjesën e prodhimit të verës nga varietetet autoktone shqiptare dhe nga ato ndërkombëtare. Pra, nuk është fare në qasjen tonë që të krijohet një monopol, sepse ne jemi aq pak kantina në Shqipëri sa, po ta marrësh nga prodhimi total, nuk arrijmë dot t'i japim një shqiptari qoftë një shishe verë.

Nuk besoj se është pjesa e monopolit... Ne thjesht po kërkojmë të jemi të barabartë me kolegët tanë në Bashkimin Europian dhe kur të prezantohemi, ta bëjmë këtë me produktet "Made in Albania".

Po kaloj te pjesa e Universitetit Bujqësor. Personalisht, por edhe kolegët, të gjitha kantinat, kantina Caco në Pogradec, kantina Nurellari në Berat, kantina Duka në Lalëz dhe shumë kantina të tjera, të gjithë pa përjashtim, kemi realisht bashkëpunimet më të mira me Universitetin Bujqësor. Pjesa e mosbashkëpunimit të mirë në disa aspekte me Universitetin Bujqësor për sa u përket studentëve të rinj ka ardhur për disa problematika për sa u takon kontratave që janë, le të themi, stazhe po ta quaj më saktë. Por kjo gjë është zgjidhur kohët e fundit.

Të gjithë ne, prodhuesit, kemi pasur bashkëpunime dhe i kemi mirëpritur studentët e rinj. Realisht ne i kemi kërkuar edhe Ministrisë, e cila po punon për pjesën e bashkëpunimit me Universitetin, sepse ai është enti, është organi më i mirë që mund të na japë të gjithë informacionin për sa i përket historisë së këtyre varieteteve dhe se ku janë mbjellë ato më përpara.

Këto janë disa nga përgjigjet që munda të jap për sa u përket pyetjeve tuaja.

Fadil Nasufi – Fjalën e ka zoti Mziu dhe pastaj zoti Duka.

Xhelal Mziu – Po ndërhyj pak këtu, se, në fakt, m'u duk vetja nganjëherë sikur punon në ministri, nisur nga argumentet që dhe.

Unë flas më gjerë sesa Arbi, pavarësisht se e frekuentoj atë verë.

Besoj se shqetësimi im ngelet në raport me, të paktën kam informacionet e nevojshme në lidhje me një kantinë vere në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut dhe në Malin e Zi në raport me një që është në Shqipëri, aspektin e përgjithshëm. Pra, nëse ju apo të gjithë të pranishmit këtu keni qenë përfitues, unë flas më gjerë sesa ju.

Së dyti, për mua ngelet shqetësim edhe një herë, unë e kam komunikuar herën e kaluar edhe me ministren, se nuk ka studentë në këto degë. Madje, në hortikulturë janë vetëm 7 studentë këtë vit. Edhe ata i kanë marrë me zor, duke ndërhyrë thjesht për të mos u mbyllur si degë, e kupton, dhe ky është shqetësim. Unë e shoh në këndvështrimin jopersonal tuajin, por më gjerë. Madje kam këmbëngulur të gjenden instrumente stimulues ose të jepen bursa, ose të gjenden metoda të tjera, ndoshta të ulet nota mesatare e të tjera. Pra, ka sa të duash instrumente që duhet ta zgjidhin.

Unë mendoj se ju jeni një zë në këtë drejtim, sepse po nuk patët burime njerëzore sot, është bërë e vështirë në tregun e punës edhe për dikë që është punëtor krahu, jo më pastaj për të pasur ndonjë specialist të kësaj fushe.

Që të ketë sukses, duhet me patjetër të kemi atë bazën për të pasur personat e certifikuar. Pra, për mua ngelet shqetësim kjo, por edhe konkurrenca... Unë shoh që mjaft qytetarë nga Shqipëria shkojnë dhe marrin rrush me tonelata në Maqedoni dhe në Kosovë. Unë besoj se ato shkojnë atje, pasi kostoja e tyre është më e ulët sesa në Shqipëri, sepse atje stimulohen.

Nëse ju thoni që jeni në pozita të barabarta, ju e dini më mirë ndoshta.

Fadil Nasufi – Po, zoti Duka.

Agron Duka – Faleminderit!

Tani, duke qenë se kjo është një seancë dëgjimore, pra këta kanë ardhur për të qarë hallet te ne, për të rregulluar ligjin, unë do të mundohem praktikisht të them dy fjalë me aq sa e njoh këtë fushë.

Gjithmonë këta e kanë në dorë, ministria... Ndërkohë, ne do të dëgjojmë këto dhe do të japim ndonjë këshillë.

Ka njëfarë të drejte faktikisht zoti Mziu, por që ndoshta vlen për një temë tjetër me ministren a ku e di unë, qoftë edhe me atë të Financave, sepse subvencionet dhe mbështetja përgjithësisht në të gjithë bujqësinë nuk janë të barabarta me ato të vendeve të rajonit. Ndosht faktikisht që shumë njerëz, të cilët prodhojnë pije alkoolike, përfshirë edhe verën, blejnë lëndë të parë rrush, sidomos në Maqedoni, shumë madje, sepse e kanë çmimin më të lirë.

Pikërisht për këtë punë këta zotërinjtë kërkojnë që, domethënë, të njihet sa më shumë, si puna e ligjit që kemi për matriculimin e kafshëve, edhe vendi i origjinës, aty ku prodhohet.

Ju, me të drejtë, e thatë se ne e kemi këtë gjë, por e kemi të përfshirë në një ligj tjetër... Ndoshta duhet ta shihni dhe të gjeni gjuhën e përbashkët që atë që e keni të përfshirë atje ta integroni në këtë ligj, sepse, si të thuash, është më konkretisht i zbatueshëm, sepse është për verën.

Përveç asaj, këto kërkojnë të ketë një organizëm, i cili mund të jetë në varësi nga Ministria e Bujqësisë, madje për t'i dhënë rëndësi edhe më shumë ndoshta, të ketë një varësi dyfishe Ministria e Bujqësisë dhe Kryeministria, siç është për shembull Drejtoria e Pyjeve, nuk e di a vazhdon të jetë ashtu apo jo, por në mënyrë që të kontrollohen origjina dhe cilësia. Pse? Sepse ne, në qoftë se konkurrojmë me verën, ne konkurrojmë pikërisht me varietetet autoktone, megjithëse klonet këtu, ai Profesor Lushi atje, që thoni ju, na degjeneron ne me gjuhën kështu, autoktone, sepse klonet këtu janë degjeneruar komplet, pasi është vazhduar të mbillet me copa me vite dhe jo me fidanë. Gjithsesi, kemi arritur të ruajmë njëfarë emri.

Për shembull, Vloshi ka një emër që, kur vjen një i huaj këtu, e kërkon këtë lloj vere, për shembull, ose disa varietete të tjera që ju i përmendët. Prandaj këta duan domosdoshmërisht ta dinë se, kur vjen i huaji këtu, ndoshta e ka dëgjuar edhe atje jashtë dhe e merr.

Për sa i përket asaj tjetrës, unë e kundërshtoj Mziun, se raporti çmim/cilësi i verërave këtu te ne ka ndryshuar. Ne e konkurrojmë shumë-shumë mirë, Maqedoninë po se po, por edhe ata të Malit të Zi, ndoshta edhe ata të Kosovës, sepse këtu ka verëra me çmime të mira dhe me cilësi të mirë.

Nga ana tjetër, do të përmendja edhe një pikë tjetër për ju të ministrisë. Duhet ta mbron produktin e vendit. Që ta mbron, do të thotë që ju të mos lejoni të hyjnë verëra pa asnjë lloj informacioni se nga dhe si vijnë, dhe çfarë kanë në përbërje.

Në Shqipëri kanë vërsuar faktikisht. Nuk mund të kundërshtosh për këtë punë, se, për ironi të fatit, meqë diskutojmë, unë jam edhe njohës i mirë i verës, jam konsumator. Këtu gjen verëra 1 euro e ca, 1,8 euro ose themi 2500 lekë e gjen në Itali. Ja, ai djali që ka mbaruar atje, edhe ky tjetri, por ka qenë shumë...

Vetëm transporti, vetëm shishja. Ore, një shishe e blen 1000 lekë këtu. E blen apo jo 1000 lekë?

(Ndërhyrje pa mikrofon): Po.

Agron Duka – Ai tjetri e shet këtu 1800 lekë. Po çfarë i ka futur brenda?

Po të bëhet kjo qendra që kërkojnë këta, kjo nuk i lë të futen ashtu pastaj, dhe është në mbrojtje të këtyre. Këtë kërkojnë këta, domethënë, dy-tre gjëra konkrete që ju t'i ashtu...

Fjala e fundit që do të kisha unë në marrëdhënie gjithmonë me Ministrinë, është dashamirësia që ju keni pasur, faktikisht, sepse në zbatimin e këtij ligji gjithmonë jeni konsultuar. Pra, në këtë lloj fryme ta vazhdoni që këtë lloj produkti, i cili po merr emër faktikisht në rajon, ndoshta edhe në botë (nuk e di nëse e dini ose jo, por ne sot kemi verëra

shqiptare që i tregtojmë në Amerikë, i tregtojmë në shtete të ndryshme të botës dhe janë të preferueshme), ju ta mbron.

Po të vazhdojmë këtu t'i shohim nen për nen, e ku di unë, ne nuk mbarojmë kurrë, sepse kjo është, si të thuash, një fushë pa fund, por gjërat që ata thanë janë të qarta. Mundohuni, sepse shihet që ju keni njëfarë sensibiliteti pozitiv, që t'i plotësoni, në mënyrë që, siç ju thashë, është një produkt që ka ecur në Shqipëri dhe jo vetëm juve, por edhe vreshtave gjatë gjithë viteve u është dhënë faktikisht një rëndësi e madhe.

Ju e dini se ne trashëguam pas viteve '90 një sasi të ulët fare, me rendiment të ulët fare, ndërkohë që sot kemi rendimente katërfish-pesëfish, përdorim preparate sistemi e të tjera.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti Duka!

Do të jepni ndonjë përgjigje ju të ministrisë apo të vazhdojmë me zotin Beqiraj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka.

Atëherë, fjalën e ka zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Më vjen mirë që në këtë tavolinë ka shumë specialistë të fushës, përveç agronomisë, por edhe të kimisë. Ju falënderoj, por nuk kishte si të mos jepja edhe unë disa sugjerime lidhur me këtë projektligj, që është tepër sensitiv, sepse ka të bëjë me një nga ushqimet e rëndësishme, se nuk po them ushqim bazë, por të rëndësishme për sofrën shqiptare, për tavolinën shqiptare, pse jo edhe të krenohemi si vend në tregjet e tjera.

Nga çfarë është debatuar konkretisht për ligjin e vreshtarisë dhe të verës, shqetësimi ka dalë që prodhuesit tanë në tregjet e huaja, por qoftë edhe në vendin tonë, janë inferiorë ndaj verërave që importohen. Cila hallkë e zinxhirit duhet korrigjuar në këtë rast, se ato lidhur me çmimet është tjetër hesap ky muhabet, në aspektin cilësor, në mënyrë që vera shqiptare të gjejë vendin e saj jo vetëm në tavolinat tona, por edhe në tregun rajonal dhe më gjerë, në mënyrë që të nxisë...? Është një stimul që nxit edhe fermerët e fushës përkatëse.

Pra, që të pasqyrohet edhe në këtë projektligj, sepse është një projektligj që korrigjon të gjithë këtë aktivitet. Shumë mirë që ka gati 2 vjet bashkëpunimi dhe diskutimi me Ministrinë e Bujqësisë, por nuk është një emergjencë që ne vetëm të nxjerrim në finale një produkt, një kornizë ligjore të zbatueshme dhe të pranueshme, që t'u krijojmë lehtësi dhe avantazh, dhe tek e fundit, në finale, nuk ka asnjë ligj të shkruar në gur, ama të kthehet në benefite ekonomike.

Lidhur me shqetësimin që ju kërkoni, lidhur me kadastrimin e zonave të vreshtarisë, nuk dua t'i dal në mbrojtje, se është vetë avokate përfaqësuesja e ministrisë, te neni 10, pika 6, kemi përcaktimin e zonave të prodhimit të rrushit.

Kjo gjë zgjidhet shumë mirë te neni 2, ku janë përkufizimet, ndaj sugjeroj të shtohet edhe përcaktimi i zonave të prodhimit të rrushit. Po u fut atje, ai është tamam si një nen dhe që aty pastaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...gjenerohet, se e pashë që nuk është i përfshirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo e zgjidh besoj edhe atë kërkesën. Përfaqësuesit e ministrisë ta mbajnë shënim dhe ne, kur ta kalojmë nen për nen, do ta trajtojmë këtë.

Nga ana tjetër, edhe në ligj, por edhe në diskutimet e kolegëve tuaj, nuk pashë se si mund të realizohet kontrolli i të gjithë zinxhirit ushqimor nga bima deri te produkti final, që ka shumë rëndësi.

Unë si kimist e di se atë që ushqehet, qoftë biomasa, qoftë qeniet e gjalla, e nxjerrin një pjesë të produktit, në mënyrë që t'i rikthehem verës sonë autoktone artizanale. Se ta pranojmë ne, inxhinierët kimistë, në teknologji, më vjen mirë që është edhe një veteran, ja edhe ju, po edhe unë ashtu si puna juaj, e dimë se gjatë përpunimit teknologjik humbasin shumë vlera që janë të virgjëra në bimë, në virgjërinë e lëndës së parë të bimës.

E dyta, në këtë ligj nuk pashë të përmendj instrumenti ose institucionet e arbitrazhit për të mbrojtur ata, që edhe kolegët parafolës i përmendën, prodhuesin, sipërmarrësin dhe konsumatorin. Kemi instrumente që mbrojnë në fusha të tjera dhe nuk kemi këtu.

Unë jam konsumator. Ma hodhe mua ti në një transaksion tregtar që bëjmë? Po si do të mbrohem? Ku do të ankojem? Se të gjitha këto institucionet kanë të bëjnë me certifikim, licencim, standardizim e të tjera. Po ky institucion?

Ju që e keni mbi shpatulla këtë punë, a e quani të nevojshme të ketë edhe laboratorë të akredituar, që luajnë rolin e arbitrazhit? Ta shikosh pastaj nëse do të hyjnë më produkte nga importi poshtë standardit dhe valencës cilësore të verës sonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të paguajë...

Tjetër çështje: çfarë mendoni për ambalazhimin, vjetërimin e verës, që është një proces delikat dhe i gjatë, si dhe për ruajtjen e saj? Si e parashikoni? E gjeni veten tuaj në këtë projektligj sipas standardeve që kërkon edhe, siç themi ne: vera kur plaket, bëhet më e mirë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fund, jo më kot, po ta hedhim në votë këtu me pjesën tjetër të opozitës, nga profesionet kemi më shumë kimistë, si është bashkëpunimi me institucionet shkencore dhe me ato të arsimit të lartë? Bashkëpunimi, sidomos për prodhuesit, ata të cilët kanë fermat e vreshtarisë dhe deri tek ata që kanë kantinat ta marrin studentin që në vit të parë në praktikë, ta nxisin që, me të drejtë, siç tha zoti Mziu, ta dinë se ka një industri këtu, ka vende pune dhe të trajtohen tamam. Nuk ka më mirë se të kesh një teknolog, një inxhinier me dije sesa të marrësh një hallexhi nga fshati...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sinqerisht, u bëra xheloz, se te këshilli i verës thoni: duhen kimistë, por nuk pashë, me një fjalë, të kishit bashkëpunim, ndaj do t'ju kërkoja që le të shikohet edhe mundësia të përfshihen edhe në këtë ligj.

Në qoftë se ne nuk e lidhim prodhimin me institucionet profesionale, qoftë me shkollat profesionale, me institucionet e larta profesionale dhe universitetet, nuk do të kemi prodhim që të konkurrojmë tregun global dhe rajonal, por edhe këtu brenda, se jemi bërë qibarë, me thënë të vërtetën.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti Beqiraj!

E do fjalën ndonjë koleg tjetër para se t'ua jap fjalën përfaqësuesve të panelit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Duraj, më vonë, që t'i mbyllim komplet dhe të dalim drejt konkludimit të dëgjësave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni?

Laert Duraj – Në fakt, i dëgjova me vëmendje të gjitha diskutimet, ndaj thjesht dy sugjerime kam.

Nga sa kuptova nga diskutimet e hollësishme të përfaqësuesve të Shoqatës së Verërave, pak a shumë, kur u tha se çfarë duhet bërë shtesë në ligj, do të doja të dija çfarë nuk është bërë mirë. Sepse mund të jetë ndonjë gjë që mund të përmirësohet nga këto që nuk u diskutuan. Pra, meqenëse jemi në kohë, të rregullojmë ndonjë gjë.

Për sa i përket pjesës së dytë pastaj, unë bashkohem tërësisht me çfarë këshillash dha zoti Duka në lidhje me ndihmën që duhet t'u jepet enologëve dhe prodhuesve të verës në Shqipëri, pasi të gjithë neve na pëlqen të kemi një lloj *one-stop shop* për të zgjidhur hallet tona kur shkojmë për çdo lloj gjëje, për një certifikatë, një licencë, për një çfarëdo.

Kështu që edhe në këtë rast prodhuesit e verërave do të donin të kishin një derë ku të trokisnin dhe të zgjidhnin të gjitha hallet që, në një kuptim, ndoshta Ministria e Bujqësisë, për mendimin tim në këtë rast, do të jetë ajo që duhet të marrë përsipër edhe negociatat me palët e treta, me institucionet e tjera, qoftë me patentat, nuk e di, kush merret me zonimin apo me shoqata të ndryshme.

Pra, në njëfarë mënyre, ndoshta ministria duhej të merrte apo të marrë përsipër, konkretisht të negociojë, le të themi, në emër të qeverisë dhe jo prodhuesit e verërave me çdo ent tjetër, institucion tjetër, që ka në fokus këtë produkt, se, në fund të fundit, është një produkt i tokës dhe Ministria e Bujqësisë është përgjegjësjë nga fillimi deri në fund për këtë gjë.

Kështu që, siç e tha edhe zoti Duka, duhet një gjë shtetërore që ta marrë këtë gjë në varësi, por këtë proces ta udhëheqë Ministria e Bujqësisë dhe drejtoritë përkatëse.

Këtë sugjerim kisha.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti Duraj!

Kush e do fjalën? Po, urdhëroni.

Aulona Veizi – Faleminderit!

Më vjen mirë që jam këtu e ftuar dhe dëgjova të gjithë kolegët e mi, por edhe ju, pra më mbetet pak. I fundit flet pak, sepse janë konsumuar tashmë shumë nga ato që do të shprehja. Gjithsesi, mendoj se kanë ngelur vetëm dy gjëra për t'u përmendur, nga ato të tjerat që kolegët e mi i përmendën dhe jam plotësisht dakord me të gjithë kolegët.

Një ndër gjërat janë termat, kufizimet, ka shumë vend për të ndërhyrë. Janë, për shembull, fortësia alkoolike, që është grada alkoolike. Kjo vjen si pasojë e përkthimit ose e tremave kimikë. Unë jam konsultuar edhe me shoqata somelierësh, por jam edhe vetë inxhinierë kimiste, kam punuar shumë vjet. Verë e gazuar e ajrosur, që duhet të jetë shkumëzuese e gazifikuar apo termi “pikë” që është verë, bërsi e holluar me ujë, pra ka disa terma dhe për këtë dua të komplimentoj grupin e punës së ministrisë, sepse është bërë një punë shumë e madhe dhe unë kam qenë qysh në fillim pjesë e këtij projektligji. Ai është përmirësuar jashtëzakonisht shumë, por mendoj që edhe këto ndërhyrje, që bëhen sot apo janë bërë në dëgjesa të tjera lidhur me këtë projektligj, duhet të merren parasysh, sepse janë disa terma që janë teknikë që ndryshojnë në përkufizim, por edhe si terma.

Do të aneksoja, gjithashtu, edhe një nen, nenin 10 të kreut III, që flet për varietetet e rrushit për verë, që i përkasin species *Vitis vinifera*, që janë përftuar nga shartimi ndërmjet varietetit të species *Vitis vinifera* dhe specieve të tjera të gjinisë, por këtu nuk përftohet asgjë

nga shartimi dhe kultivarët për verën, që i përkasin vetëm species së tillë, si Vitis vinifera dhe bimët janë të gjitha të shartuara.

Pra, në praktikën agronomike, hardhitë, pavarësisht nga kultivarët, duhet domosdoshmërisht të shartohen. Sidoqoftë, unë kam një material të mirëpunuar dhe do t'ia dërgoj grupit të punës për ta parë më me hollësi.

Kam edhe një gjë tjetër. U përmend shumë herë këtu vera Vlosh. Unë vij nga Vlora dhe kjo verë është vërtet shumë e mirë dhe uroj që ky projektligj të kalojë sa më shpejt me të gjitha përpunimet e tij, sepse është në të mirë të zonave rurale, të fermerëve që të kenë produktet e tyre zonale apo të mbrojtura, në mënyrë që të kemi një turizëm rural dhe shumë të zhvilluar.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Zeqja!

Baftjar Zeqaj – Në qoftë se ne do të biem dakord që do të ngrihet kjo agjenci, unë jam dakord që të ngrihet se i jep një autoritet tjetër gjithë kësaj gjëje që ne po diskutojmë sot, por duhet të presim përgjigjen e ministrisë.

Dy përfaqësuesit, që janë këtu, nuk besoj se e kanë këtë kompetencë që thonë se do të ngrihet apo jo agjencia.

Në qoftë se do të ngrihet agjencia, për të cilën ne po biem dakord, pa folur për detyrat e saj, duhet pak kohë që të thuhet se agjencia do të marrë përsipër këto 3-4 çështje që ju i keni si gangrenë, kontrollin e verës që vjen nga importi, trashëgiminë e verës që është shumë e rëndësishme për të ardhëm edhe analizën e verërave që ju prodhoni, për të cilën foli Ismeti, njëkohësisht do të rritet edhe konkurrenca e të tjera. Të gjitha këto u thanë, por ne duhet, në rast se biem dakord, të krijojmë një hapësirë kohe, dy javë apo një muaj, që shumë nga këto të përfshihen dhe ta mbyllim këtë kapitull me konsensus.

Fadil Nasufi – E mbajta shënim propozimin tuaj dhe të gjitha propozimet e tjera.

Baftjar Zeqaj – Unë mendoj se këto çështje që u trajtuan këtu, përfshi edhe agjencinë, ne do t'i rrisim autoritetin gjithë verës shqiptare dhe do të bëjmë një gjë të mirë, duke filluar nga ky moment dhe më tej.

Fadil Nasufi – Zoti Kaçorri.

Rigers Kaçorri – Dua të bëj një ndërthurje të vogël. Realisht, i falënderoj të gjithë për pjesën e mendimeve, por më ngacmoi profesor Ismeti për sa i përket pjesës së teknologëve dhe personave që merren me pjesën e prodhimit.

Ne i kemi kërkuar ministrisë që te pjesa e ligjit të mendohet të jetë një protokoll për sa i përket prodhimit, është ajo që përmendëm më parë për sa i përket produkteve bio, produkteve të veçanta, sepse, duke pasur një protokoll, që është i certifikuar gjithmonë nga të gjitha entet ose nga enti që do të krijohet, pjesa e kimit dhe pjesa e laborantëve, sepse të gjithë ne kemi laboratorët e brendshëm, por kemi edhe laboratorët e jashtëm dhe kjo është një pikë shumë e rëndësishme për të pasur një protokoll prodhimi.

Nga ai protokoll prodhimi, pastaj gjithsecili me njohuritë e veta më të mira ose më specifike mund të prodhojë një produkt kundrejt këtij protokoll bazë, por protokoll është informues, nuk do të jetë detyrues dhe këtu jam plotësisht dakord me profesorin.

Gazmend Shehi – Doja të përshëndesja profesor Ismetin për ndërhyrjen që bëri te neni 2. Unë e thashë që në fillim se ne kemi bërë skanim të ligjit sipas neneve, por nuk ishte ndoshta momenti për të diskutuar nen për nen, por, meqenëse u përmend neni 2, mendoj që të shtohet një pikë tjetër, pika 9, dhe të vendoset vera tradicionale ose artizanale shqiptare që mund të jetë në ndonjë rajon të caktuar dhe mendoj se duhet të bëhet lobing që me ligj të mos paguajnë akcizë, sepse, siç e tha profesori, vera është ushqim. Por vetëm për këtë produkt, verën artizanale, sepse ka edhe një institucion që trajton Dhoma e Zejtarisë që mund të jetë pjesë e kësaj. Ai që plotëson këto kritere, mund të ndihmohet dhe të promovohet produkti si i tërë, si produkt shqiptar.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti Shehi!

A ka prononcime të tjera?

Urdhëroni!

Evald Domi – Jam enolog dhe vij nga kantina “Duka”.

Duke qenë se shumica e gjërave janë diskutuar në këtë panel, dy pikat kryesore që kisha unë për pjesën e ligjit, është pjesa e ADN-së së varieteteve autoktone. Cili do të jetë institucioni që do t’i përcaktojë ADN-të?

Një faktor tjetër është edhe akciza që paguhet. Ndoshta kemi edhe përfaqësues të ministrisë së Financave në një moment tjetër. Akciza e verës nga viti 2022 është rritur pa i njoftuar subjektet. Është një rritje prej 10% për rakinë dhe për verën, ndërsa për pjesën e ADN-së të varieteteve autoktone kërkoj një përgjigje nga Ministria e Bujqësisë se cili do të jetë institucioni që do të përcaktojë varietetet autoktone. Ne kemi fshatra, siç është fshati Shesh në Shqipërinë e Mesme, fshati Kallmet, zona e Pulsit dhe Vloshi në Vlorë. Mendoj se këto fshatra, duke qenë se varietet janë mbjellë që në kohën e komunizmit, kanë vazhduar të shumëfishohen, por edhe të degradohen në të njëjtën kohë.

Ftoj edhe anëtarët e komisionit që të ngrenë një grup pune me profesorë të Universitetit Bujqësor që të bëjnë vlerësimin aktual se si është gjendja e varieteteve autoktone.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti Domi!

A ka prononcime të tjera?

Julinda Bare – Lidhur me varietetet autoktone, ne kemi bashkëpunuar me Universitetin Bujqësor të Tiranës. Në universitet është një bankë gjenetike, e trashëguar nga Ministria e Bujqësisë. Kjo bankë ruan të gjitha varietetet, plus Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Vlorë ka një laborator të analizave gjenetike, kështu që të dyja mund t'i shfrytëzojmë për të arritur aty ku ne kërkojmë të arrijmë.

Fadil Nasufi – Meqenëse jemi te kjo çështje, a kemi ne fidanishte të certifikuara me varietete autoktone?

Alban Mësonjësi – Janë institucionet për pjesën e certifikimit dhe sot që flasim, certifikojnë pjesën e varieteteve që vijnë nga banka gjenetike e Universitetit Bujqësor, është si ent, por ne mendojmë që te pjesa e ligjit të jepet një zë i fortë, sepse kjo është pjesa më e rëndësishme e ligjit, sepse po bëjmë një ligj që të mbrojmë varietetet autoktone.

Pjesën e varieteteve ndërkombëtare kanë qenë dhe do t'i kemi përherë, por pjesa e varieteteve autoktone është gjëja më e rëndësishme që ne duhet të kemi dhe t'i japim hapësirën e duhur të gjitha zonave të Shqipërisë.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit!

Roland Dama – Ndërhyrjen që bëri Gazi për sa i përket prodhimit të vogël, pavarësisht se e përmendi pak më ngushtë, si prodhim artizanal, unë do ta lidhja pak edhe me subvencionet që janë dhënë në lidhje me agroturizmin të prirur drejt minikantinave të verës.

Kjo është një ndër pyetjet që unë bëra në fillim, por në ligj ka një ndërhyrje deri në masën 50 hektolitra, pastaj ka disa ndërhyrje të tjera në lidhje me sasinë që nuk mund t'i nënshtrohet ligjit për mjedisin, por ngelen gjithnjë jo të qarta.

Unë do të thosha që një agroturizëm mbi bazën e një kantine vere që pretendon të administrojë një hektarë vresht, që mund të kalojë nga 50 hektolitra në diçka më tepër, fuqinë për ta mbikëqyrur, për të krijuar licencë e shoh të pamundur, ndaj edhe ndërhyra për afatin 2-vjeçar të tyre.

Këtë e kisha si shtesë për ndërhyrjen e Gazit me gjitha këto investime që Ministria e Bujqësisë ka bërë për këtë agroturizëm.

Fadil Nasufi – Faleminderit!

Unë, edhe në cilësinë e relatorit të këtij projektligji, vura re që ka shumë propozime që duhet të pasqyrohen në projektligj. Ishte një dëgjese me shumë vlerë, sepse u fol edhe me gjuhë praktike në lidhje me përballjet që kanë sot kantinat, por edhe vreshtaria në përgjithësi.

Presim nga Ministra e Bujqësisë që këto propozime, që u bënë, të shqyrtohen, që nga ngritja e agjencisë për produktet e origjinës dhe deri tek mbyllja e ciklit në një kontroll të vetëm për sa i përket bilancit import-eksport dhe goditjes që person produkti vendas nga ndërhyrjet e shumë institucioneve, por të jenë në një ligj organik, AKU-ja, doganat, inspektorati e të tjera.

Këto çështjet teknike që keni, adresojini pranë sekretarisë, me qëllim që grupi i punës dhe unë si relator, me të gjithë aktorët e tjerë, të mund t'i përfshijmë në nenet përkatëse.

Kam edhe një përvojë nga këto kantinat e Beratit edhe për sa i përket produktit autokton, por edhe të qenit shumë konkurrues në treg. Nuk e pashë zotin Nurellari, se ishte i ftuar. Gjithsesi, jeni për t'u përsëndetur që keni arritur edhe në këto kushte kur ka pasur edhe informalitet, të certifikoheni me emër dhe të përfaqësoheni denjësisht në tregun e konkurrencës.

Ne kemi lënë, pas kësaj dëgjese, të bëjmë një vizitë si komision në kantinën e kolegut tonë Ramadan Lika, ndërkohë do të punojmë në proces për të pasqyruar të gjitha propozimet dhe adresimet specifike për t'u përfshirë në këtë projektligj.

Faleminderit!

Këtu e mbylлим mbledhjen.

MBYLLET MBLEDHJA